



Komuna e Shtimes
Zyra e Prokurimit

Nr. 03/1/57

Datë: 25.9.2018

KONTRATË PËR FURNIZIM

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani, tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit në njëren anë:

dhe

N.T.P. “Office – Printy” Prishtinë që e përfaqëson Nexhmije Koca, i autorizuar nr. i tel. 045-501-110 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:
“Furnizim me Ditar dhe Fletore Pune”, me numër Identifikues 617-2018-088-136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë :**“Furnizim me Ditar dhe Fletore Pune”**.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **25.09.2018 dhe përfundon me 15.10.2018**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **15 ditë** nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i *dërgimit të furnizimeve* do të jetë : **Shkollat e Komunës së Shtimes**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 1898.40 €
(Njëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë € e katërdhjetë cent)

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë (Faturë) nga OE dhe raporti i Menaxherit të Kontratës të caktuar nga AK për furnizimin e kryer .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për NA

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nexhmije Koca	Emri:	Ilir Gashi
Pozita:	Drejtoreshë	Pozita:	U.D. Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25.09.18	Data:	25.09.2018
Vula:	OFFICE-PRINTY	Vula:	

Prishtinë

KOMAGJ
KOSOVË
SHITES-OPERA
KOSOVA
SHTIME-ŠTIMLJE

1. Emin Duraku

Nr.	Përshkrimi	Nj. Mat.	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Libër I klasës (I-V)	cope	24	8.70	208.80
2	Libër I klasës (I-V) me kurrikul	cope	16	8.70	139.20
3	Libër I klasës (VI-IX)	cope	16	8.70	139.20
4	Libër I klasës (VI-IX) me kurrikul	cope	14	8.70	121.80
5	Libër I klasës për parafillorë (0) me kurrikul	cope	6	8.70	52.20
6	Libër I kujdestarisë 200 fletë A4 (	cope	5	6.00	30.00
7	Libër për regjistrim të nx e kl. I me kurrikul	cope	1	6.50	6.50
8	Libër amë për nx.kl.I (parë) me kurrikul	cope	1	18.00	18.00
9	Libër amë për nx.kl. (VI-IX) me kurrikul	cope	1	18.00	18.00
Totali:					733.70€

2. Naim Frasheri

Nr.	Përshkrimi	Nj. Mat.	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Ditar Klase sipas kurikules per shkollen e mesem	cope	26	8.70	226.20 €

3. Shkolla profesionale

Nr.	Përshkrimi	Nj. Mat.	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Ditar Klase sipas kurikules per shkollen e mesem	cope	28	8.70	243.60€

4. Hasan Prishtina

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Fletore pune (për mësimdhënës) Me kurrikul formati A-4	copë	30	1.50	45.00
2	Libër I klasës (I-V) 10 me kurrikul:	copë	10	6.50	65.00
3	Libër I klasës (VI-IX) 8 me kurrikul	copë	8	6.50	52.00
4	Libër I klasës për parafillor (me kurrikul)	copë	2	18.00	36.00
5	Libër I kujdestarisë 200 fletë A4 (shtyp i dyanshmëm)	copë	1	5.50	5.50
6	Libri amë për nxënës Shkollë fillore me kurrikul	copë	1	17.00	17.00
7	Libri amë për nxënës (VI-IX) me kurrikul	copë	1	17.00	17.00



	Totali:	237.50€
--	---------	---------

5. Lasgush Poradeci

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Fletore pune (për mësimdhënës) B-5	copë	20	1.50	30.00
2	Libër I klasës (I-V) 10 me kurrikul: 16 të tjerë	copë	26	5.50	143.00
3	Libër I klasës (VI-IX) 8 me kurrikul ; 8 të tjerë	copë	16	5.40	86.40
4	Libër I klasës për parafillor (me kurrikul)	copë	4	5.50	22.00
5	Libër I kujdestarisë 200 fletë A4 (shtyp i dyanshmëm)	copë	5	8.00	40.00
6	Libri amë për nxënës Shkollë fillore me kurrikul	copë	4	17.00	68.00
7	Libri amë për nxënës (VI-IX) me kurrikul	copë	4	17.00	68.00
Totali:					457.40€

Nr.	REKAPITULIMI		
1.	Emin Duraku	Totali	733.70
2.	Naim Frasheri	Totali	226.20
3.	Shkolla profesionale	Totali	243.60
4.	Hasan Prishtina	Totali	237.50
5.	Lasgush Poradeci	Totali	457.40
GJITHSEJT TOTALI:			1,898.40€

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	OFFICE-PRINTY
ADRESA E PLOTE	RR. AGIM RAMADANI
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	NEXHMIJE KOCA
POZITA	DREJTORESHË
NENSHKRIMI	
DATA	27.08.2018
VULA	

